

**VENDIM**

**I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË “GLOBAL CHANGE” SHPK**

**NR.1, DATË 14.03.2023**

Sot më Datë 14.03.2023, **Z.Alban Papushi, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë “Global Change” Shpk**, Shoqëri me NIPT M22321020I, me Seli në Adresën Bulevardi “Zogu i Parë”, Shkalla 0, Përballë me Tirana Bank, Zona Kadastrale 8360, Nr.Pasurie 6/133-N1, Tiranë,

**VENDOSI**

1. Rritjen e Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë “Global Change” Shpk, në formë monetare, në një vlerë prej 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi:  
Kapitali i Regjistruar **ishte:** 100 (njëqind) Lekë;  
Kapitali I Regjistruar **bëhet:** 2,500,100 Lekë.
3. Kapitali i Shoqërisë, do të rritet përmes të ardhurave personale të Ortakut të vetëm të Shoqërisë, Z.Alban Papushi (jo nga fitimet e Shoqërisë). Bazuar në Udhëzimin Nr.5, Datë 30.06.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” I ndrushuar, për këto të ardhura personale të Ortakut të vetëm, të cilat do të përdoren për të zmadhura kapitalin e regjistruar të Shoqërisë, është lëshuar Vërtetimi Nr.9977 Prot, Datë 13.03.2023 i Drejtorisë Rajonale Tatimore, i cili konfirmon origjinën e ligjshme të të ardhurave.
4. Vlera ndryshuar e Kapitalit, është shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm i saj në llogarinë bankare të Shoqërisë “Global Change” Shpk pranë Credins Bank.
5. Me depozitimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit të këtij Vendimi së bashku me mandatin bankar të shlyerjes së kapitalit të regjistruar, **vlera e Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë dhe të shlyer nga Ortaku**, të reflektohet në Regjistrin Tregtar.

**SHOQËRIA “GLOBAL CHANGE” SHPK  
ORTAKU I VETËM  
ALBAN PAPUSHI**

*Alban Papushi*  
